

**FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE
PASQYRAT FINANCIARE**

Më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	i-iii
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRSHIRËSE	2
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË AKTIVET NETO	4
SHËNIME SHPJEGUESE MBI PASQYRAT FINANCIARE	5-33

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtuesit e ‘Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme’, Shoqëri Administruese e Fondeve të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme e krijuar sipas ligjit nr.133/2016 nga Banka e Shqipërisë, për qëllime të zbatimit të instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme (“Fondi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2022, pasqyrën fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në fondin e sigurimit të depozitave dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit me datën 31 dhjetor 2022, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me kërkesat e raportimit financiar sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bazat për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Fondi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Fondin, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Fondit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Fondin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plotë dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga drejtimi, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

20 mars 2023

Kledion Doolra, FCCA

Kad



FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
AKTIVET			
Aktivitet afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	8	8,235,698	62,803,450
Instrumente financiare të mbajtur për të mbledhur flukset kontraktuale	9	3,520,996,283	2,655,544,667
TOTALI I AKTIVEVE		3,529,231,981	2,718,348,117
DETYRIMET			
Detyrime të tjera	10	2,873,098	2,315,381
TOTALI I DETYRIMEVE		2,873,098	2,315,381
AKTIVET NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME			
Aktivitet neto në dispozicion të ANJ		2,716,032,735	1,994,251,351
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		810,326,148	721,781,385
TOTALI AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		3,526,358,883	2,716,032,736
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I AKTIVEVE NETO NË DISPOZICION TË AUTORITETIT TË NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME		3,529,231,981	2,718,348,117

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera gjithëpërshtirëse***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

TË ARDHURA	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura operative			
Të ardhura nga kontributi vjetor	11	734,598,664	664,127,540
Të ardhura nga interesat	12	92,529,737	63,946,706
TOTALI I TË ARDHURAVE		827,128,401	728,074,246
SHPENZIME FINANCIARE			
Humbje nga përkthimi në monedhë të huaj		(13,722,258)	(3,811,350)
TOTALI I SHPENZIMEVE FINANCIARE		(13,722,258)	(3,811,350)
SHPENZIME OPERATIVE			
Shpenzime operative nga aktiviteti	13	(2,873,097)	(2,315,383)
TOTALI I SHPENZIMEVE OPERATIVE		(2,873,097)	(2,315,383)
Shpenzime provigjioni të instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale	8,9	(206,898)	(166,128)
TEPRICA NETO PËR VITIN		810,326,148	721,781,385
TEJKALIMI I TË ARDHURAVE NDAJ SHPENZIMEVE PËR VITIN		-	-
TOTALI I TË ARDHURAVE GJITHËPËRSHIRËSE		810,326,148	721,781,385

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

	Shënime	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin		810,326,148	721,781,385
Rregullime për:			
Të ardhura nga interesat		(92,529,737)	(63,946,706)
Levizja në fondin e provigjonit për instrumentet financiare		420,467	166,128
Ndryshimet në:			
Detyrime të tjera		557,716	(216,369)
Interesi i arkëtuar		107,830,121	36,000,251
Fluksi i mjeteve monetare gjeneruar nga aktiviteti operativ		826,604,715	693,784,689
AKTIVITETI INVESTUES			
Shtesat e instrumenteve financiare të mbajtur për të mbledhur flukse kontraktuale neto		(881,172,467)	(656,998,000)
Blerë gjatë vitit		(1,853,360,000)	(2,161,000,000)
Maturuar gjatë vitit		972,187,533	2,817,998,000
Fluksi i mjeteve monetare përdorur në aktivitetin investues		(881,172,467)	(656,998,000)
Rritja / neto e mjeteve monetare gjatë vitit		(54,567,752)	36,786,689
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të viti	8	62,803,450	26,016,761
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	8	8,235,698	62,803,450

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivet neto***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)*

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme	
Aktivët neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 01 Janar 2020	1,303,587,643
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	690,663,708
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	690,663,708
Aktivët neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2020	1,994,251,351
Tejkalimi i të ardhurave ndaj shpenzimeve për vitin	721,781,385
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	721,781,385
Aktivët neto në dispozicion të autoritetit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2021	2,716,032,736
Teprica neto nga veprimtaria për periudhën	
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin	810,326,148
Aktivët neto në dispozicion të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme më 31 dhjetor 2022	3,526,358,884

Shënimet shpjeguese paraqitur në faqet 5 deri në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë miratuar me Vendim të Këshilli Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave Nr 8, datë 20 mars 2023, dhe nënshkruar në emër të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nga:

z. Genci Mamani
Drejtore i Përgjithshëm



znj. Ornela Shqarri
Përgjegjëse e Sektorit të
Financës dhe Investimeve

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI ENTITETIN RAPORTUES

Fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme (Fondi) u krijua më 1 janar 2018 në zbatim të ligjit 133/2016 " Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (Ligji). Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme administrohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave ("Agjencia" ose "ASD") në përputhje me parashikimet e këtij Ligji dhe akteve të tjera nën ligjore të miratuara për këtë qëllim nga Banka e Shqipërisë. Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk ka personalitet juridik. Banka e Shqipërisë është Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme që ushtron të drejtat e ndërhyrjes të përcaktuara në Ligj. Çdo pretendim në lidhje me "Fondin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme" i drejtohet Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Objekti i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i rregullave, i procedurave dhe i instrumenteve për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka dhe degët e bankave të huaja;
- b) përcaktimi i kompetencave dhe i detyrave të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe të Autoritetit Mbikëqyrës;
- c) krijimi, financimi dhe përdorimi i fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe administrimi i tij.

Fondi duhet të plotësohet gradualisht dhe të arrijë nivelin 0.5% të detyrimeve të të gjitha bankave, brenda datës 11 korrik të vitit 2027. Banka e Shqipërisë si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përllëgarit çdo vit kontributin vjetor që sektori bankar do të paguajë për arrijten e nivelit të synuar të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, do të përdoret për të mundësuar zbatimin e instrumentave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të parashikuar në Ligj.

Për vitin e parë mbështetur në Ligjin dhe rregulloren nr.56 datë 03.10.2017 "Mbi Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurave për administrimin e tij", të ndryshuar, niveli i synuar, madhësia e Fondit në vitin e parë dhe kontributi vjetor për secilën bankë është mbështetur në pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016. Madhësia e Fondit të synuar shpërndahe sipas peshës specifike që çdo bankë zë në detyrimet e të gjithë sektorit bankar.

Për vitin e katër bankat kanë paguar të gjithë kontributin respektivisht deri në datën 30 Prill 2021, sipas shumës së llogaritur nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Për vitin e pestë bankat kanë paguar të gjithë kontributin respektivisht deri në datën 30 Prill 2022, sipas shumës së llogaritur nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. KUADRI RREGULLATOR I VEPRIMTARISË SË FONDIT

Veprimtaria e Fondit rregullohet nga ligji "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", akteve nën ligjore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë si edhe nga rregulloret e hartuara nga Agjencia dhe të miratuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përbëhet nga burimet financiare të mëposhtme:

- a) kontributet vjetore të paguara nga bankat;
- b) kontributet e jashtëzakonshme të paguara nga bankat;
- c) huatë, subvencionet dhe donacionet. Huat mund të garantohen duke përdorur aktivet e tashme dhe/ose të ardhshme të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";
- ç) të ardhura nga administrimi i mjeteve financiare të "Fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme";

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

2. KUADRI RREGULLATOR I VEPRIMTARISË SË FONDIT(VAZHDIM)

d) të ardhurat nga rimarrja e fondeve të përdorura gjatë zbatimit të kompetencave dhe instrumenteve të parashikuara në këtë ligj;

dh) gjokat e mbledhura nga zbatimi i sanksioneve të përcaktuara në nenin 81 të këtij ligji;

e) instrumente të tjera financiare, të përcaktuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Banka e Shqipërisë, si Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, miraton përdorimin e Fondit, ndërsa Agjencia përcakton mënyrën e investimit dhe tipet e instrumenteve në të cilat do të investohet Fondi në zbatim të politikës për administrimin e mjeteve financiare të miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Administrimi i Fondit duhet të garantojë sigurinë e mjeteve financiare përmes investimit në mjete me likuiditet të lartë dhe rrezik të ulët. Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton procedurat, kriteret, maturitetet dhe limitet krahasuese. (benchmark).

Mjetet financiare të Fondit duhet të investohen në letra me vlerë të lëshuara nga Qeveria e Shqipërisë, Banka e Shqipërisë, qeveritë e huaja, bankat qendrore ose institucione financiare ndërkombëtare të cilat janë të vlerësuara shumë mirë nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit me reputacion (AAA/AA-). Sipas Ligjit, Agjencia duhet të mbajë llogari financiare të veçanta për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Në fund të çdo viti financiar, Agjencia përgatit një raport mbi aktivitetin investues të këtij Fondi dhe e dërgon pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Organi më i lartë drejtues i Fondit është Këshilli Drejtues i Agjencisë. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Banka e Shqipërisë. Dy anëtarë propozohen nga Banka e Shqipërisë, dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë dhe një anëtar propozohet nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

Anëtarët e Këshillit Drejtues janë jo ekzekutiv, me përjashtim të anëtarit që emërohet në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm. Ligji për sigurimin e depozitave, i ndryshuar përcakton se afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, me të drejtë rizgjedhje, bazuar në treguesit e performancës të veprimtarisë së tyre.

Këshilli Drejtues më 31 dhjetor 2022 përbëhet nga:

Z. Donald Duraj	Kryetar i Këshillit Drejtues (KD)
Z. Genci Mamani	Anëtar
Znj. Adelina Xhemali	Anëtare
Z. Shkelzen Margjeka	Anëtar

3. BAZAT E PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË SNRF

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"-të).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

3. BAZAT E PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË SNRF(VAZHDIM)

c) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Fondit.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën, në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme të ndikuara.

Informacione rreth çështjeve të rëndësishme të sigurisë në vlerësime dhe gjykimeve kritike për zbatimin e politikave kontabël, që kanë efektin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë përfshirë në Shënimet 6 dhe 7.

e) Parimi i Vijmësisë

Pasqyrat financiare të Fondit janë përgatitur në bazë të supozimi i vijmësisë, i cili supozon se Fondi do të vazhdojë ekzistencën e tij operacionale për të ardhmen e parashikueshme. Në zbatim të Ligjit, Fondi do të plotësohet gradualisht dhe të arrijë nivelin 0.5% të detyrimeve të të gjitha bankave, brenda datës 11 korrik të vitit 2027. Për të përmbushur nivelin e synuar të fondit, sektori bankar paguan çdo vit një kontribut vjetor, në përpjesëtim me vitet që mbeten deri në 2027.

Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, Fondi bazuar në sa më sipër dhe gjithashtu në përputhje të planit të miratuar financiar në vitet e ardhshme, parashikon të rrisë aktivitetin e tij operacional dhe ka parashikuar të arrijë një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm.

4. ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR

4.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022

Disa standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2022 dhe që janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Fondit. Për këtë arsye informacioni shpjegues lidhur me këto Standarde nuk është dhënë në pasqyrat e Fondit.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

4. ZBATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË REJA DHE TË RISHIKUARA TË RAPORTIMIT FINANCIAR (VAZHDIM)

4.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar më parë nga Fondi

Standarde dhe amendamente të tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Fondi përfshijnë:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Amendamentet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Amendamentet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kuaderin Konceptual
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontratat e ndertimit - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)
- Tatimi i shtyrë i lidhur me Aktivet dhe Detyrimet nga një transaksion i vetëm

Këto amendamente nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye informacioni shpjegues nuk është përfshirë.

Fondi ka zgjedhur të mos adoptojë këto standarde të reja, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e reja përpara datës kur hyjnë në fuqi.

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

5.1 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e asaj date. Fitimi ose humbja nga zërat monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat e periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj e përkthyer me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të përkthyer në monedhë të huaj, të cilat mbahen me kosto historike, ripërkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kursi i këmbimit, të cilat janë rezultat i ripërkthimit, njihen në fitim/humbje.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore, të përdorura për të përkthyer zërat e bilancit në LEK janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
EUR	114.23	120.76
Dollari amerikan (USD)	107.05	106.54

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.2 Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Për aktivet financiare, ndryshe nga ato që janë blerë ose origjinuar me rrezik kreditor të shtuar, norma e interesit efektiv është norma që aktualizon në mënyrë të saktë flukset e ardhshme hyrëse dhe dalëse të parave përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit apo detyrimit financiar (ose, ku është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) ndaj vlerës kontabël bruto të aktivitetit apo detyrimit financiar në njohjen fillestare. Për instrumentet financiarë të blerë ose të origjinuar me rrezik të shtuar kreditor, një normë e rregulluar efektive interesi llogaritet duke

aktualizuar flukset e ardhshme të parasë duke përfshirë humbjet e pritshme ndaj kostos së amortizuar në njohjen fillestare të instrumentit. Norma e interesit efektiv për instrumentet financiarë të Fondit të cilët janë të gjithë të vlerësuar jo me rrezik të shtuar kreditor është norma që aktualizon flukset hyrëse dhe dalëse të parave përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit apo detyrimit financiar ndaj vlerës kontabël bruto të aktivitetit apo detyrimit financiar në njohjen fillestare.

5.3 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifrat dhe komisionet, të cilat janë përbërëse e normës së interesit efektiv të një aktivi apo detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

5.4 Aktivitetet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Fondi i njeh fillimisht investimet në letra me vlerë, depozitat, huatë dhe detyrimet e tjera të varura në ditën në të cilën ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit, e cila është data kur Fondi angazhohet të blejë apo shesë aktivet. Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare (përfshirë dhe aktivet dhe detyrimet e mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes) njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data në të cilën Fondi bëhet palë e dispozitave të kontratës së instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Aktivitetet financiare

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij.

Klasifikimi i aktiveve financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare me kosto të amortizuar:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përftuar të ardhurat kontraktuale; dhe
- në marrëveshjen bazë të emetimit të aktivitetit të përcaktohet që flukset hyrëse/kthimet do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur papaguar.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIMI)

5.4 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten pas njohjes fillestare maten me vlerë të drejtë përmes të ardhurave gjithëpërfshirëse:

- Instrumentet e borxhit të cilat mbahet sipas një modeli biznesi që ka si qëllim të mbajë këto aktive financiare për të përfutur të ardhurat kontraktuale; dhe
- të shesë instrumentet financiarë dhe të cilat kanë flukse hyrëse/kthime që do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur paguar.

Si rezultat të gjithë aktivet e tjera financiare maten me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes.

Kosto e amortizuar dhe interesi efektiv

Kosto e amortizuar e aktivitetit financiar është shuma me të cilën matet aktivi në njohjen fillestare duke zbritur pagesat e principalit dhe duke shtuar amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të diferencës midis vlerës së njohur fillimisht dhe vlerës në maturim, të rregulluar për provigjonet nga humbjet. Vlera kontabël bruto e aktivitetit financiar është kosto e amortizuar e aktivitetit përpara rregullimit për ndonjë provigjon nga humbjet.

Fitimi ose humbja nga konvertimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Specifikisht, për aktivitetet financiare që maten me Kosto të Amortizuar dhe që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje mbrojtëse të caktuar diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në fitim ose humbje (shenimi 11);

Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021, aktivitetet financiare të Fondit përbëhen nga mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, dhe letrat me vlerë të klasifikuara si të mbajtuara për të mbledhur flukset. Shiko Shënimet 5.6, 5.7 dhe 5.8.

Detyrimet financiare

Fondi i klasifikon detyrimet e tij financiare, përveç garancive financiare dhe angazhimeve të huasë, si të matura me kosto të amortizuar ose me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 detyrimet financiare të Fondit përbëhen vetëm nga të pagueshmet ndaj Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të matura me koston e amortizuar.

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Fondi njih një provigjon për humbjet e pritshme për aktivitetet financiare të cilat maten me kosto të amortizuar ose me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të gjithëpërfshira. Shuma e humbjes së pritshme vlerësohet në çdo datë raportimi për të reflektuar ndryshimet në rrezikun kreditor që nga njohja fillestare e instrumentit financiar. Fondi gjithmonë vlerëson humbjet e pritshme për gjithë jetëgjatësinë e instrumentit financiar kur ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor që nga njohja fillestare. Megjithatë nëse nuk ka një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor. Fondi vlerëson provigjonin nga humbja e kredisë në shumën e humbjeve të pritshme për 12 muajt e jetës së aktivitetit financiar.

Humbjet e pritshme nga kredia për të gjithë jetën e aktivitetit financiar do të rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme humbjeje përgjatë jetës së instrumentit financiar. Ndërkohë, humbja e pritshme për 12 muajt e fundit përfaqëson pjesën e humbjeve të pritshme nga humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës së asetit, që pritet të rezultojë nga ngjarjet e humbjeve që mund të ndodhin brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.4 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

(i) Rritje e konsiderueshme në rrezikun kreditor

Në vlerësimin nëse ka një rrezik të shtuar kreditor për një instrument financiar që nga njohja fillestare, Fondi krahason rrezikun e humbjes nga instrumenti financiar në datën e raportimi me rrezikun e humbjes në datën e njohjes fillestare. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Fondi konsideron informacionin sasior dhe cilësor që është i pranueshëm dhe i dokumentueshëm duke përfshirë eksperiencën historike dhe informacion mbi të ardhmen i cili mund të sigurohet pa shumë kosto dhe përpjekje. Informacion mbi kushtet e ardhshme konsideron perspektivat e ardhshme të sektorit në të cilën operon Fondi, analiza financiare nga ekspertë financiarë, vlerësime nga agjenci ndërkombëtare vlerësimi, analiza nga institucione shtetërore apo organizata të tjera të ngjashme, si edhe burime të tjera të informacionit për parashikimin ekonomik aktual dhe të ardhshëm, i cili lidhet me aktivitete kryesore të Fondit. Veçanërisht, informacioni i mëposhtëm është marrë në konsideratë kur është vlerësuar nëse ka rritje të rrezikut kreditor nga njohja fillestare:

- një përkeqësim aktual ose i pritshëm i vlerësimit të jashtëm ose të brendshëm të instrumentit financiar;
- përkeqësim i konsiderueshëm në treguesit e tregjeve të jashtme të treguesve kreditor për instrumentet financiare
- ndryshime në rënie të kushteve ekonomike, dhe financiare aktuale ose të parashikuara të cilat presin të shkaktojnë një përkeqësim të aftësisë paguese të debitorit për të paguar detyrimet kontraktuale;
- një përkeqësim i konsiderueshëm aktual apo i pritshëm në rezultatet operative të debitorit
- rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor në një instrument tjetër financiar të lëshuar nga i njëjti debitor

Pavarësisht këtyre, Fondi vlerëson që rreziku i kredisë për instrumentet financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga njohja fillestare nëse vlerësohet që instrumenti ka rrezik të ulët kredie në datën e raportimi.

Një instrument ka rrezik të ulët kredie në datën e raportimi nëse:

- (1) Instrumenti financiar ka një rrezik të ulët humbjeje,
- (2) Debitori ka aftësi të forta paguese për të plotësuar detyrimet e tij kontraktuale në të ardhmen e afërt
- (3) Ndryshime të kundërta në kushtet ekonomike dhe kushtet e biznesit në afatgjatë të cilat jo domosdoshmërisht pakësojnë aftësinë e debitorit për të plotësuar detyrimet kontraktuale.

Fondi konsideron që një aktiv financiar ka rrezik të ulët kredie kur aktivi ka vlerësime të jashtëm si "investment grade" në përputhje me përkufizimin ndërkombëtar të njohur për këto investime ose nëse një vlerësim i jashtëm mungon, aktivi ka një vlerësim të brendshëm si aktiv financiar me performancë të mire, e cila konsideron që kundërpala ka një pozicion të fortë financiar dhe nuk ka detyrime në vonesë. Fondi vlerëson në mënyrë të rregullt efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun kreditor dhe të rishikojë këto kritere në mënyrë të përshtatshme për të siguruar që kriteret janë të vlefshme për të identifikuar një rritje të konsiderueshme të rrezikut kreditor përpara se shumëat e pritshme të jenë në vonesë.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.4 Aktivët dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

(ii) Përkufizimi i humbjes

Fondi konsideron ngjarjet e mëposhtme si evente të humbjes për qëllime të menaxhimit të brendshëm të rrezikut kreditor pasi historiku i ngjarjeve ka treguar që nëse një aktiv financiar plotëson një nga kriteret e mëposhtme zakonisht nuk mund të arkëtohen:

- kur ka një thyerje të treguesve financiarë nga debitori; ose
- informacioni i krijuar së brendshmi apo i marrë nga burime të jashtme tregon që debitori ka pak mundësi pagese për kreditorët e tij duke përfshirë edhe Fondi.

Pavarësisht analizave të mësipërme. Fondi konsideron që një humbje ka ndodhur kur aktivi financiar është më shumë se 90 ditë në vonesë për aq kohë sa Fondi ka evidenca të arsyeshme dhe të mbështetura për të treguar një kriteri i ndryshëm humbjeje do të ishte më i përshtatshëm.

Matja e humbjeve të pritshme është një funksion i probabilitetit të humbjes, humbja e mundshme dhe ekspozimi ndaj humbjes. Vlerësimi i probabilitetit të humbjes dhe mundësisë së humbjes mbështetet në të dhëna historike të rregulluar me informacion për të ardhmen siç përshkruhet më sipër.

Ndërsa ekspozimi ndaj humbjes për aktivet financiare, përbëhet nga shuma bruto e aktivitetit në datën e raportimit. Për aktivet financiare, humbja e pritshme vlerësohet si diferenca midis të gjitha flukseve kontraktuale që i detyrohen Fondit sipas detyrimeve kontraktuale dhe flukseve të pritshme për tu marrë nga Fondi të aktualizuara me normën origjinale efektive të interesit në momentin e investimit. Fondi njuh një humbje apo të ardhur nga zhvlerësimi i të gjitha aktiveve financiare në pasqyrën e fitimit humbjes, me rregullimin përkatës në vlerën kontabël të tyre përmes një llogarie humbjeje nga provigjoni, me përjashti të instrumenteve të matur me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, për të cilat provigjoni njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe mbledhet në rezervën e rivlerësimit të investimeve dhe nuk pakëson vlerën kontabël të aktivitetit financiar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(iv) Çrregjistrimi

Fondi çrregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset e parasë përfundojnë apo i transferon të drejtat për të marrë flukset e parasë me anë të një transaksioni, i cili transferon në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia e aktivitetit financiar, ose në të cilin Fondi, as nuk mban dhe as nuk transferon në thelb rreziqet dhe përfitimet e ardhshme që rrjedhin nga pronësia dhe as nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar. Çdo interes i krijuar apo i mbajtur nga Fondi mbi aktivet financiare të transferuara, të cilat kualifikohen për çrregjistrim, njihet më vete si aktiv apo detyrim.

Në çrregjistrimin e një aktiviteti financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlerës së mbartur që i alokohet pjesës së transferuar të aktivitetit) dhe shumës së (i) shumave të marra (përfshirë çdo aktiv të ri në zotërim minus çdo detyrim të ri të marrë) dhe (ii) çdo fitim apo humbje kumulative të njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim/ humbje.

Detyrimet financiare

Fondi çrregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të saj janë përmbushur, ndërprerë apo anuluar.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.4 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

(iv) Kompensimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten me shumën neto në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur, Fondi ka një të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe kur ajo ka si qëllim ose t'i shlyejë ato me vlerën neto ose ta realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten me bazë neto vetëm kur lejohet nga SNRF-të, ose për fitim/humbje që rrjedhin nga transaksione të ngjashme.

(v) Matja e kostos së amortizuar

Kosto e amortizuar e një aktivi apo detyrimi financiar është vlera, me të cilën është njohur në fillim aktivi apo detyrimi financiar, minus pagesat e shlyerjes së principalit, plus apo minus amortizimin e akumuluar, duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë midis shumës fillestare të njohjes dhe shumës në maturim, minus çdo zbritje apo zhvlerësim.

(vi) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi, me të cilën një aktiv do të këmbehej, ose një detyrim do të shlyejë, në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme, mes palëve të gatshme, të mirë informuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën, në datën e matjes.

Kur është e mundur, Fondi mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e listuar në një treg aktiv të këtij instrumenti. Një treg konsiderohet aktiv, nëse çmimet e listuara janë direkt dhe rregullisht të disponueshme dhe përfaqësojnë transaksione aktuale dhe të rregullta të tregut, të kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën. Kur nuk ka çmim të listuar në një treg aktiv, Fondi përdor ato teknika vlerësimi të cilat maksimizojnë përdorimin e të dhënave përkatëse të verifikueshme dhe minimizojnë ato jo të verifikueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët, që pjesëmarrësit në treg do të merrnin parasysh në përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Informacioni më i mirë për të përcaktuar vlerën e drejtë të një instrumenti financiar gjatë njohjes fillestare të tij është normalisht çmimi i transaksionit, p.sh. vlera e drejtë e shumës së dhënë apo marrë. Nëse Fondi përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk përcaktohet, as me anë të një çmimi të listuar në një treg aktiv për një aktiv apo detyrim të njëjtë dhe as duke u bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor të dhëna nga tregje të verifikueshme, instrumenti financiar fillimisht njihet me vlerën e drejtë, të rregulluar, për të shmangur diferencën midis vlerës së drejtë në njohje dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim/humbje mbi një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se koha kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhëna të verifikueshme të tregut apo transaksioni është mbyllur.

Nëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë, ka një çmim oferte dhe një çmim kërkese, Fondi i mat aktivet dhe pozicionet e gjata me çmim oferte dhe detyrimet dhe pozicionet e shkurtra me çmim kërkese.

Politika kontabël e matjes me vlerën e drejtë të Fondit është paraqitur në Shënimin 7.1.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.4 Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(iii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Fondi mat vlerën e drejtë duke ndjekur renditjen e mëposhtme të vlerave të drejta që pasqyrojnë rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjeve:

- **Kategoria 1:** të dhëna që janë çmimet e tregut të listuara (të parregulluara), në një treg aktiv për instrumenta të njëjtë.
- **Kategoria 2:** të dhëna, të ndryshme nga çmimet e listuara në treg të përfshira në nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme si drejtpërdrejt (si p.sh. çmimet) apo jo drejtpërdrejt (p.sh. të rrjedhura nga çmimet). Kjo kategori përfshin instrumentat e vlerësuar duke përdorur: çmimet e tregut të listuara në një treg aktiv të instrumentave të ngjashëm; çmimet e listuara të instrumentave të njëjtë ose të ngjashëm në tregje që konsiderohen më pak se aktiv; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë të verifikueshme drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me të dhënat e tregut.
- **Kategoria 3:** të dhëna jo të verifikueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet, në të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë të dhëna jo të bazuara në informacione të verifikueshme dhe ku të dhënat jo të verifikueshme kanë ndikim të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumenta që vlerësohen në bazë të çmimeve të listuara për instrumenta të ngjashëm, që kërkojnë rregullime apo supozime të paverifikueshme, të rëndësishme për të pasqyruar diferencat midis instrumentave.

Vlerat e drejta të aktiveve dhe detyrimeve financiare, të tregtueshme në tregje aktive, bazohen në çmimet e tregut të listuara apo listimet e çmimeve nga ana e tregtuesit. Për të gjithë instrumentat e tjerë financiarë, Fondi përcakton vlerat e drejta duke përdorur teknika të tjera vlerësimi.

Teknika të tjera vlerësimi përfshijnë modelet e vlerës aktuale neto dhe të aktualizimit të flukseve të parasë dhe krahasime me instrumenta të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime të verifikueshme të tregut.

Qëllimi i teknikave të vlerësimit është matja e një vlere të drejtë, e cila të reflektojë çmimin që do të ishte marrë në shitje të aktivit apo do të ishte paguar për transferimin e detyrimit, në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes.

Çmimet e verifikueshme dhe të dhënat e modelit janë zakonisht të disponueshme në tregjet e letrave me vlerë, derivativëve të tregtueshëm dhe derivativëve të thjeshtë mbi banak (jashtë bursave) si suop-et e normës së interesit. Disponueshmëria e çmimeve të verifikueshme të tregjeve dhe të dhënave të modelit ul nevojën e gjykimeve dhe vlerësimeve nga ana e Drejtimit dhe gjithashtu ul pasigurinë lidhur me përcaktimin e vlerave të drejta. Disponueshmëria e çmimeve dhe të dhënave të verifikueshme të tregjeve luhet në varësi të produkteve dhe tregjeve, si dhe priret të ndryshojë në bazë të kushteve të përgjithshme dhe ngjarjeve të caktuara në tregjet financiare.

Fondi njuh transferimet midis kategorive në renditjen e vlerave të drejta në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

5.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë llogaritë rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë dhe depozitat shumë likuide në Bankën e Shqipërisë me afat maturimi 7 ditë, që janë të ekspozuara ndaj një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe që përdoren nga Fondi në administrimin e aktivitetit të saj. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar, e cila përafrohet me vlerën e drejtë për shkak të natyrës afatshkurtër të tyre.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

5.6 Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale

Një aktiv ose detyrim financiar, kur ky nuk përcaktohet si i matur me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes, matet fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen apo shitjen e tij. Aktivet financiare të Fondit klasifikohen si të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale sepse modeli i biznesit të Fondit është mbajtja e këtyre aktiveve financiare për të përfituar të ardhura kontraktuale dhe në marrëveshjen bazë të emetimit të aktivit të përcaktohet që flukset hyrëse/kthimet do të shlyhen në data të caktuara dhe janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të përlogaritur mbi principalin e mbetur paguar.

5.7 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Fondi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të kërkohet një dalje e përfitimeve ekonomike për të shlyer detyrimin.

5.8 Krahasueshmëria

Disa vlera krahasuese në pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare dhe pasqyrës së ndryshimeve në fondet e sigurimit të depozitave janë riklasifikuar ose riparaqitur si rezultat i një ndryshimi në klasifikim për të pasqyruar një efekt më të mire

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Gjatë rrjedhjes së zakonshme të veprimtarisë, Fondi është e ekspozuar ndaj një sërë rreziqesh financiare, ku më të rëndësishmit janë rreziku i tregut (ku përfshihet rreziku i monedhës, rreziku i ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe në normat e interesit), rreziku i kredisë dhe rreziku i likuiditetit. Administrimi i rrezikut në përgjithësi fokusohet në identifikimin e rreziqeve, që mund të ndikojnë në rezultatet dhe pozicionin financiar të Fondit, si dhe në minimizimin e efekteve negative potenciale që mund të vijnë nga këto rreziqe.

Rreziqet financiare aktualisht identifikohen, maten dhe kontrollohen përmes mekanizmave të ndryshme, të ndërmarra për të vlerësuar si duhet ngjarjet e tregut lidhur me investimet dhe mënyrat e mbajtjes së aktiveve likuide me qëllim parandalimin e përqendrimit të tepruar të rrezikut.

Administrimi i mjeteve financiare të Fondit rregullohen nga ligji 133/2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë” dhe Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” (“Politika e Administrimit të FNJ”), e miratuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Politika e Administrimit të FNJ përcakton strukturën e portofolit të Fondit, kriteret për minimizimin e rreziqeve në administrim, dhe kushtet e procedurat për vendimmarrjen dhe zbatimin e administrimit të mjeteve financiare. Administrimi i mjeteve financiare të Fondit kryhet duke ndjekur këto parime: a) parimi i likuiditetit, sipas të cilit titujt në të cilët janë investuar mjetet financiare duhet të kthehen në lekë sa më shpejt dhe me kosto sa më të ulët; b) parimi i sigurisë, sipas të cilit investimet diversifikohen dhe mjetet financiare investohen në tituj të ndryshëm nga lloji dhe/ose maturimi dhe me rrezik kreditor sa më të ulët; dhe c) parimi i normës së kthimit, sipas të cilit duhet të synohet që norma reale e kthimit nga instrumentet financiarë në të cilët janë investuar mjetet të jetë sa më e lartë.

Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme njofton menjëherë Agjencinë për përshtatjen e shpërndarjes në transhe sipas nevojave të saj ose ndërprerjen e veprimtarisë investuese në rastet e nevojës për likuiditet apo nevojave të tjera urgjente, në zbatim të ligjit 133/2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”. Instrumentat financiar të lejuar rregullohen nga ligji 133/2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka në Republikën e Shqipërisë” dhe Politika e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme” (“Politika e Administrimit të FNJ”)

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

Sipas këtyre akteve mjetet financiare investohen në tituj të emtuar nga qeveri ose banka qendrore të huaja, ose institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit (vlerësim jo më të ulët se AA-/Aa3) ose tituj të emtuar nga Qeveria e Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë. Gjithashtu mjetet financiare mund të vendosen në depozita afatshkurtra/llogari rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë ose institucione financiare ndërkombëtare të vlerësuara si të sigurta nga agjenci të njohura të vlerësimit të kreditit (vlerësim jo më të ulët se AA-/Aa3).

Për qëllime të administrimit, mjetet financiare organizohen në dy transhe. Transhi i likuiditetit shërben për mbulimin e nevojave në rastin e një ndërhyrje të jashtëzakonshme, ngjarjeje sigurimi të mundshme dhe nevojave për mbulimin e shpenzimeve për administrimin e FNJ. Ky transh përfshin gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur nga 0 - 3 muaj. Madhësia e këtij transhi në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 10% e totalit të mjeteve financiare për Fondin. Transhi i investimit përfaqëson mjetet financiare pasi zbritet transhi i likuiditetit. Ky transh përfshin titujt me maturitet të mbetur deri në 10 vjet. Titujt me maturitet të mbetur mbi 2 vjet nuk mund të kenë një vlerë më të madhe se 30% e totalit të mjeteve financiare të Fondit. Me qëllim minimizimin e rreziqeve, transhi i investimit duhet të synojë një shpërndarje të shkallëzuar të maturiteteve. Kalimi nga ky transh në transhin e likuiditetit kryhet në përputhje me nevojat e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për mjete likuide. Madhësitë e transheve të likuiditetit dhe të investimit përcaktohen nga Komiteti i Investimeve me synimin për të arritur një shpërndarje të shkallëzuar të maturiteteve.

Me qëllim administrimin e rrezikut ndaj monedhës dhe luhatjeve në kursin e këmbimit, mjetet financiare të Fondit mbahen në lek dhe monedhë të huaj. Monedhat e huaja të lejuara janë dollar Amerikan dhe EUR. Pesha e secilës monedhë përcaktohet në strategjinë vjetore të investimit të mjeteve financiare. Mjetet financiare në monedhë të huaj për Fondin nuk duhet të jenë më pak se 5% e totalit të mjeteve financiare të këtij fondi bazuar në Rregullore Nr. 17, datë 28.07.2016 "Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të ASD", e ndryshuar. Gjithashtu, me qëllim garantimin e aftësisë për të përmbushur detyrimet në rast të një ndërhyrjeje të jashtëzakonshme, me kërkesë të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, burimet dhe mjetet financiare mund të plotësohen nëpërmjet huasë nga Buxheti i Shtetit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.1 Rreziku i kreditor**

Rreziku kreditor është rreziku i humbjes financiare i shkaktuar Fondit nëse pala tjetër në një instrument financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale dhe vjen kryesisht nga investimet në letra me vlerë të Fondit dhe gjendjeve të llogarive në Bankën e Shqipërisë. Për qëllime raportimi lidhur me administrimin e rrezikut, Fondi merr parasysh dhe përfshin të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor, siç janë rreziku i dështimit të debitorëve individualë dhe rreziku i shtetit.

Komiteti i Investimeve është struktura përgjegjëse për mbikqyrjen e rrezikut kreditor, përfshirë rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut kreditor, si dhe garantimin e përputhshmërisë me kufijtë e vendosur në lidhje me ekspozimin ndaj palëve të treta/shteteve dhe me politikat e tjera përkatëse të përcaktuara në aktet nënligjore.

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin ndaj rrezikut kreditor sipas palëve të treta (shteteve) dhe vonesat në ripagim apo zhvlerësimet e lidhura me to, nëse ka:

Investimet në letra me vlerë	Qeveria e Shqipërisë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2022</i>		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	3,292,536,283	3,292,536,283
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kerkesave të SNRF 9	228,460,000	228,460,000
TOTALI	3,520,996,283	3,520,996,283

Investimet në letra me vlerë	Qeveria e Shqipërisë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2021</i>		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	2,558,855,011	2,558,855,011
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kerkesave të SNRF 9	96,689,656	96,689,656
TOTALI	2,655,544,667	2,655,544,667

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	Banka e Shqipërisë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2022</i>		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	2,711,535	2,711,535
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kerkesave të SNRF 9	5,524,163	5,524,163
TOTALI	8,235,698	8,235,698

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	Banka e Shqipërisë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2021</i>		
Jo me vonesë apo të zhvlerësuara	400,000	400,000
Jo me vonesë por të zhvlerësuar sipas kerkesave të SNRF 9	62,403,450	62,403,450
TOTALI	62,803,450	62,803,450

FONDI I NDËRHJRJES SË JASHTËZAKONSHME**Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)**

Tabela më poshtë paraqet instrumentet financiarë për vitin 2022 dhe 2021 sipas shkallëve të SNRF 9

	2022			Totali
	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	
	Shkallët sipas Humbjes së Pritshme nga Aktivët Financiare			
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	3,521,766,400	-	-	3,521,766,400
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8,254,437	-	-	8,254,437
Vlera bruto	3,530,020,837	-	-	3,530,020,837
Provigjonet	(788,855)	-	-	(788,855)
Vlera kontabel, neto	3,529,231,982	-	-	3,529,231,982

	2021			Totali
	Shkalla 1	Shkalla 2	Shkalla 3	
	Shkallët sipas Humbjes së Pritshme nga Aktivët Financiare			
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukset kontraktuale	2,655,894,317	-	-	2,655,894,317
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	63,035,757	-	-	63,035,757
Vlera bruto	2,718,930,074	-	-	2,718,930,074
Provigjonet	(581,957)	-	-	(581,957)
Vlera kontabel, neto	2,718,348,117	-	-	2,718,348,117

Fondi nuk ka angazhime financiare të kushtëzuara më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.1 Rreziku kreditor (vazhdim)

Fondi përdor klasifikimet e rrezikut kreditor për aktivet dhe detyrimet financiare të publikuara nga njesitë nderkombetare S&P për percaktimin e probabilitetit të dështimit si mëposhtë:

Klasifikimi sipas S&P 2022	Institucioni	Probabiliteti i dështimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	0.64%
B+	Banka e Shqipërisë	0.64%
Klasifikimi sipas S&P 2021		Probabiliteti i dështimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	0.70%
B+	Banka e Shqipërisë	0.70%

6.2 Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku ndryshimit të çmimit të tregut të aktiveve, si rezultat i një ndryshimi të normave të interesit, kurseve të këmbimit dhe marzhet në interesat e kredisë (jo lidhur me ndryshimet në cilësinë e kreditimit të emetuesit/debitorit), të cilët do të ndikojnë në të ardhurat e Fondit ose vlerën e instrumenteve financiarë të zotëruar prej saj. Qëllimi i Fondit në administrimin e rrezikut të tregut është drejtimi dhe kontrolli mbi ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, me qëllim sigurimin e aftësisë paguese të Fondit duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

(i) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - investimet e mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale*

Rreziku kryesor, ndaj të cilit janë ekspozuar portfolet jo-të-tregtueshme, është rreziku i humbjeve nga luhajtjet e flukseve të ardhshme të parasë të instrumentave financiare ose vlerave të drejta të tyre, për shkak të një ndryshimi në normat e interesit në treg. Rreziku i normës së interesit administrohet kryesisht duke monitoruar ekspozimin neto në instrumentet financiare që mbartin interes dhe duke miratuar paraprakisht kufijtë për këto ekspozime. Komiteti i Investimeve është organi mbikqyrës i përputhshmërisë me këto kufij.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)

(ii) *Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit – investimet të mbajtura për të mbledhur fluksat kontraktuale (vazhdim)*

Një përmbledhje e pozicionit neto të Fondit në portofolet jo-të-tregtueshme sipas maturitetit të mbetur paraqitet si më poshtë:

	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	12 - 24 muaj	Mbi 24 muaj
Më 31 dhjetor 2022							
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	8,235,698	8,235,698	-	-	-	-	-
Investime të mbajtura për të mbledhur fluksa kontraktuale	3,520,996,283	-	443,511,143	700,000,000	90,654,339	1,256,830,802	1,030,000,000
TOTALI	3,529,231,981	8,235,698	443,511,143	700,000,000	90,654,339	1,256,830,802	1,030,000,000

Më 31 dhjetor 2021

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre
 Investime të mbajtura për të mbledhur fluksa kontraktuale

	Vlera kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj	12 - 24 muaj	Mbi 24 muaj
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	62,803,450	62,803,450	-	-	-	-	-
Investime të mbajtura për të mbledhur fluksa kontraktuale	2,655,544,667	-	322,955,988	652,591,948	-	859,705,251	820,291,480
TOTALI	2,718,348,117	62,803,450	322,955,988	652,591,948	-	859,705,251	820,291,480

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)***(i) Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit - instrumentë financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale (vazhdim)*

Drejtimi mori parasysh një skenar standard që përfshin një ulje ose rritje paralele prej 100 pikësh bazë (bp) në të gjitha kurbat e normave të interesit në botë. Një analizë e ndjeshmërisë së Fondit ndaj një rritjeje apo uljeje në normat e interesit të tregut paraqitet më poshtë:

Ndryshimi në normë	Më 31 dhjetor 2022
+100bp	35,292,320
-100bp	(35,292,320)

Ndryshimi në normë	Më 31 dhjetor 2021
+100bp	27,183,481
-100bp	(27,183,481)

(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Rreziku i monedhës përkufizohet, si rreziku që luhet në kurset e këmbimit të shkaktuar nga ndryshime të rëndësishme, pozitive ose negative, në pasqyrën e pozicionit financiar. Fondi është kryesisht i ekspozuar ndaj rrezikut të ndryshimeve në kursin e këmbimit të EUR ndaj LEK-ut. Ekspozimet aktuale dhe kufizimet lidhur me to vendosen dhe monitorohen në përputhje me Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare të Fondit.

Një përmbledhje e ekspozimit neto ndaj monedhës paraqitet më poshtë (vlerat në LEK):

Më 31 dhjetor 2022	LEK	EUR
AKTIVET		
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,730,274	5,505,424
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	3,293,306,400	227,689,883
TOTALI	3,296,036,674	233,195,307
DETYRIMET		
Detyrime të tjera	2,873,097	-
TOTALI I DETYRIMEVE	2,873,097	-
EKSPOZIMI NETO NDAJ KURSIT TË KËMBIMIT	3,293,163,577	233,195,307

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME**Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare***(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)***6. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.2 Rreziku i tregut (vazhdim)***(ii) Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit (vazhdim)*

Më 31 dhjetor 2021	LEK	EUR
AKTIVET		
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	419,282	62,384,168
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	2,559,286,317	96,258,350
TOTALI	2,559,705,599	158,642,518
DETYRIMET		
Detyrime të tjera	2,315,381	-
TOTALI I DETYRIMEVE	2,315,382	-
EKSPOZIMI NETO NDAJ KURSIT TË KËMBIMIT	2,557,390,218	158,642,518

Analiza e ndjeshmërisë ndaj monedhës së huaj

Tabela më poshtë paraqet ndjeshmërinë ndaj një rritje/rënie me 1,500 pikë bazë në kurset e këmbimit të LEK-ut ndaj EUR në datën e raportimit bazuar në strukturën e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj të Fondit më 31 dhjetor, duke supozuar se të gjithë variablat e tjerë mbeten të pandryshuar. Efekti është matur dhe paraqitur si një ndikim në rezultat dhe direkt në aktivet neto, duke mbajtur të pandryshuara kushtet e tjera.

	EUR	
	+15%	-15%
Më 31 dhjetor 2022	34,979,296	(34,979,296)
	EUR	
	+15%	-15%
Më 31 dhjetor 2021	23,796,378	(23,796,378)

Me një rritje prej 15 përqind në kursin e këmbimit të EUR ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Fondit do të ishte një rritje me vlerë si në tabelën e mësipërme.

Me një ulje prej 15 përqind në kursin e këmbimit të EUR ndaj LEK-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet neto të Fondit do të ishte i njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes së përshkruar më sipër.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)
6.3 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Fondi do të përballlet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të saj të lidhura me detyrimet e saj financiare që shlyhen duke dhënë para apo një aktiv tjetër financiar. Politika e administrimit të likuiditetit të Fondit është konservatore, duke mbajtur një rezervë optimale e të qendrueshme mjeteshe monetare dhe burimesh shtese financiare për të siguruar kapacitetin e duhur për financimin e aktiviteve të saj. Për më shumë informacion mbi Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit dhe burimeve shtesë financiare referohuni në fillim të shënimit 6.

Tabela më poshtë paraqet instrumentat financiarë të Fondit të klasifikuara sipas periudhës së mbetur dhe parave kontraktuale të aktualizuara:

Më 31 dhjetor 2022	Vlera					Flukset totale kontraktuale të parase		
	kontabël neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj		12 - 24 muaj	Mbi 24 muaj
AKTIVET								
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8,235,698	8,235,698	-	-	-	-	-	8,235,698
Instrumente financiare të mbajtura për të mblodhur flukse kontraktuale	3,520,996,283	-	443,511,143	700,000,000	90,654,339	1,256,830,802	1,030,000,000	3,520,996,283
TOTALI	3,529,231,981	8,235,698	443,511,143	700,000,000	90,654,339	1,256,830,802	1,030,000,000	3,529,231,981
DETYRIMET								
Detyrime të tjera	(2,873,097)	-	(2,873,097)	-	-	-	-	(2,873,097)
TOTALI	(2,873,097)	-	(2,873,097)	-	-	-	-	(2,873,097)
HENDEKU KUMULATIV I LIKUIDITETIT	3,526,358,884	8,235,698	440,638,046	700,000,000	90,654,339	1,256,830,802	1,030,000,000	3,526,358,884

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

Më 31 dhjetor 2021	Vlera kontabël					Mbi 24 muaj	Flukset totale kontraktuale të parasë
	neto	deri në 1 muaj	1 - 3 muaj	3 - 6 muaj	6 - 12 muaj		
AKTIVET							
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	62,803,450	62,803,450	-	-	-	-	62,803,450
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse kontraktuale	2,655,544,667	-	322,955,988	652,591,948	-	859,705,251	2,655,544,667
TOTALI	2,718,348,117	62,803,450	322,955,988	652,591,948	-	859,705,251	2,718,348,117
DETYRIMET							
Detyrime të tjera	(2,315,381)	-	(2,315,381)	-	-	-	(2,315,381)
TOTALI	(2,315,381)	-	(2,315,381)	-	-	-	(2,315,381)
HENDEKU KUMULATIV I LIKUIDITETIT	2,716,032,736	62,803,450	320,640,607	652,591,948	-	859,705,251	2,716,032,736

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatueshmërinë e politikave kontabël dhe vlerave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet bazë rishikohen në vazhdimësi. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën, në të cilën këto vlerësime janë rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të ndikuar nga këto rishikime.

Drejtimi diskuton me Këshillin Drejtues të Agjencisë zhvillimin, përzgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël të rëndësishme dhe zbatueshmërinë e tyre dhe supozimet e bëra lidhur me pasiguritë kryesore në vlerësim. Informacionet mbi supozimet dhe pasiguritë në vlerësim, që kanë një rrezik të rëndësishëm që të rezultojnë në korrigjim material në vitin e ardhshëm financiar, dhe informacione mbi gjykime të rëndësishme gjatë zbatimit të politikave kontabël, që kanë ndikimin më të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare, janë paraqitur më poshtë.

Drejtimi mori parasysh një skenar standard që përfshin një ulje ose rritje paralele prej 10% në treguesin e mundësisë së humbjes (MH). Një analizë e ndjeshmërisë së humbjeve të mundshme nga kredia të Fondit ndaj një rritjeje apo uljeje në treguesit e matjes së humbjes paraqitet më poshtë:

	Mundësia e Humbjes	
	+10%	-10%
Provizioni më 31 dhjetor 2022 për mjetet monetare	1,874	(1,874)

	Mundësia e Humbjes	
	+10%	-10%
Provizioni më 31 dhjetor 2021 për mjetet monetare	23,231	(23,231)

Këto pasqyra plotësojnë shënimet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shiko Shënimin 6).

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

7. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

7.1 Vlerësimi i instrumenteve financiarë

Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta të instrumentave financiare janë të paraqitura më poshtë:

	Aktive financiare me kosto të amortizuar	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
Më 31 dhjetor 2022						
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	8,235,698	-	-	-	8,235,698	8,235,698
Instrumente financiare të mbajtura për të mblodhur flukse të kontraktuara	3,520,996,283	-	-	-	3,520,996,283	3,368,405,122
TOTALI	3,529,231,981	-	-	-	3,529,231,981	3,376,640,820
DETYRIMET						
Detyrime të tjera	-	-	-	(2,873,097)	-	(2,873,097)
TOTALI	-	-	-	(2,873,097)	-	(2,873,097)

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

	Aktive financiare me kosto të amortizuar	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATEGj)	Investime të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDPFH)	Të tjera me koston e amortizuar	Vlera kontabël neto	Vlera e drejtë
Më 31 dhjetor 2021						
AKTIVET						
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	62,803,450	-	-	-	62,803,450	62,803,450
Instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse të kontraktuara	2,655,544,667	-	-	-	2,655,544,667	2,678,426,046
TOTALI	2,718,348,117	-	-	-	2,718,348,117	2,741,229,496
DETYRIMET						
Detyrime të tjera	-	-	-	(2,315,381)	-	(2,315,381)
TOTALI	-	-	-	(2,315,381)	-	(2,315,381)

Për shkak të afatit të shkurtër të maturimit, Drejtimi vlerëson se vlerat e drejta të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, dhe detyrimet e tjera janë të njëjta me vlerat kontabël neto më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021. Drejtimi vlerëson vlerën e drejtë të instrumente financiare të mbajtura për të mbledhur flukse të kontraktuara në letra me vlerë, duke përdorur normat e verifikueshme të tregut (kategoria 2) për letra me vlerë të ngjashme me afat të ngjashëm maturimi, bazuar në afatin e mbetur për të mbledhur flukse të kontraktuara më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

8. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTET E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
<i>Gjendjet në banka</i>		
Depozitat afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (7 ditore)	2,730,000	400,000
Llogaritë rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë EUR	5,524,163	62,616,475
Llogaritë rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë ALL	274	19,282
Zbritur provigjoni për llogaritë bankare në monedhë të huaj	(18,739)	(232,307)
TOTALI	8,235,698	62,803,450

Në "Politikën e administrimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme", e miratuar në 27 mars 2020 nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, përcaktohet që transhi i likuiditetit në asnjë rast nuk mund të jetë më pak se 10% e totalit të mjeteve financiare. Ky transh përfshin gjendjen në llogaritë rrjedhëse, depozitat, si dhe titujt me maturitet të mbetur nga 0 - 3 muaj (shih dhe shënimin 9). Depozitat e vendosura në Bankën e Shqipërisë investohen në zbatim të VKM nr.39 të BSH datë 18 korrik 2007, me maturitet 7 ditor dhe normë kthimi 10bp më pak se norma bazë e interesit. Vlerësimet e institucioneve në të cilat Fondi mban llogari bankare në lekë dhe monedhë të huaj jepen në shënimin 6.1.

Fondi vlerëson rrezikun kreditor për llogaritë bankare në monedhë të huaj pranë Bankës së Shqipërisë dhe ka llogaritur humbjet e pritshme nga kredia sipas modelit të ndërtuar për implementimin e SNRF 9, duke përdorur propabilitetin e humbjes, ekspozimin ndaj humbjes dhe mundësitë e humbjes. Më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, levizja e provigjoni të njohur për llogaritë bankare në monedhë të huaj pranë Bankës së Shqipërisë jepet në vijim:

	2022	2021
Teprica në 1 Janar		
Shpenzime provigjoni njohur gjatë vitit	(232,307)	(88,853)
Rimarrje provigjoni gjatë vitit	-	(143,454)
Teprica mbyllëse më 31 Dhjetor	213,569	-
	(18,738)	(232,307)

9. INSTRUMENTE FINANCIARE TË MBAJTUR PËR TË MBLEDHUR FLUKSET KONTRAKTUALE

Letrat me vlerë sipas vlerës së tyre kontraktuale paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Letra me Vlerë të QSH në vlerë nominale	3,503,360,000	2,622,608,000
Interes i përlllogaritur për obligacionet e QSH	35,478,998	24,358,070
Prim/(skonto) e përlllogaritur nga obligacionet e QSH	(15,683,741)	9,106,304
Skonto nga BTH	(1,388,857)	(178,057)
Zbritur provigjoni për letrat me vlerë në monedhë të huaj	(770,117)	(349,650)
TOTALI	3,520,996,283	2,655,544,667

	2022	2021
Teprica në 1 Janar		
Shpenzime provigjoni njohur gjatë vitit	(349,650)	(326,976)
Rimarrje provigjoni gjatë vitit	(420,467)	(22,674)
Teprica mbyllëse më 31 Dhjetor	(770,117)	(349,650)

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

9.1 Letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare

Investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare janë të detajuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Letra me Vlerë në LEK	3,292,536,283	2,558,855,011
Letra me Vlerë në EUR	228,460,000	96,689,656
TOTALI	3,520,996,283	2,655,544,667

<i>Klasifikimi sipas S&P</i>	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Qeveria e Shqipërisë B+	3,520,996,283	2,655,544,667
TOTALI	3,520,996,283	2,655,544,667

Instrumentat financiare sipas afatit kontraktual të maturimit paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2022	Norma mesatare e ponderuar	31 dhjetor 2021	Norma mesatare e ponderuar
<i>LVL në LEK</i>				
0-12 muaj	1,244,900,000	2.5%	975,547,935	0.85%
24 muaj	1,000,000,000	3.2%	763,015,596	2.22%
7 vjet	1,030,000,000	4.9%	820,291,480	4.06%
<i>LVL në EUR</i>				
24 muaj	228,460,000	2.2%	96,689,656	1.96%
TOTALI	3,503,360,000		2,655,544,667	

Fondi vlerëson rrezikun kreditor dhe humbjet e pritshme duke përdorur propabilitetin e humbjes, ekspozimin ndaj humbjes dhe mundësinë e humbjes. Drejtimi i Fondit konsideron analiza historike si edhe informacion për të ardhmen për të vlerësuar ndonjë humbje të pritshme. Më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021, të gjitha letrat me vlerë që Fondi zotëron janë të Qeverisë Shqiptare. Fondi vlerëson që për letrat me vlerë në LEK të QSH rreziku kreditor është pothuajse zero, dhe rrjedhimisht provigjioni përkatës jo material për përdoruesit e informacionit financiar. Drejtimi ka përllogaritur por nuk ka njohur asnjë provigjion për këto letra me vlerë në këto pasqyra financiare.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

10. DETYRIME TË TJERA

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Detyrime ndaj Agjencisë për tarifën e administrimit	2,873,098	2,315,381
TOTALI	2,873,098	2,315,381

Detyrimet ndaj Agjencisë për tarifën e administrimit lidhet me shumën që Fondi do t'i rimbursojë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për kostot direkte dhe indirekte që lidhen me administrimin e Fondit për vitin 2022 dhe 2021. Kjo shumë përbëhet nga vlera 576,000 Lek si shpenzime direkte për auditimin e jashtëm të Fondit (2021: 576,000 Lek) dhe nga vlera 2,297,097 Lek (2021: 1,739,382 Lek) për rimbursimin e kostove indirekte (shënimi 14). Gjithashtu me vendim nr.58/2018 i miratuar në mbledhjen e datës 7.10.2020 nga Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë, Fondi i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme është përjashtuar nga mbajtja e komisioneve për llogaritë e hapura në sistemet e pagesave të Bankës së Shqipërisë.

11. TË ARDHURA NGA KONTRIBUTI VJETOR

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022, të ardhurat nga kontributi vjetor i bankave për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme ishin në shumën 734,598,664 Lek (2021: 664,127,540 Lek).

Për vitin e parë mbështetur në Ligjin 133/2016 " Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë " dhe rregulloren nr.56 datë 03.10.2017 "Mbi Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurave për administrimin e tij", e ndryshuar, niveli i synuar, madhësia e Fondit në vitin e parë dhe kontributi vjetor për secilën bankë është mbështetur në pasqyra financiare për vitin 2016. Fondi duhet të plotësohet gradualisht dhe të arrijë nivelin 0.5% të detyrimeve të të gjitha bankave, brenda datës 11 korrik të vitit 2027.

Mbështetur në të dhënat e bilanceve të audituara të bankave, për periudhën dhjetor 2020, nga përlllogaritjet e kryera nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kontributi vjetor i bankave për vitin e katërt ishte 664,127,540 Lek i cili është paguar plotësisht deri në 30 prill 2021 nga të gjitha bankat.

Mbështetur në të dhënat e bilanceve të audituara të bankave, për periudhën dhjetor 2021, nga përlllogaritjet e kryera nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, kontributi vjetor i bankave për vitin e pestë është 734,598,664 Lek i cili është paguar plotësisht deri në 30 prill 2022 nga të gjitha bankat.

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura nga kontributi vjetor	734,598,664	664,127,540
TOTALI	734,598,664	664,127,540

FONDI I NDËRHJRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

12. TË ARDHURAT NGA INTERESAT

Të ardhurat nga interesat për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 janë krijuar nga aktivitetet e mëposhtme:

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura nga investimet në Bono Thesari (BTH)	4,305,763	2,021,692
Të ardhura nga investimet në Obligacione	86,231,621	61,663,407
Depozita afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë	1,992,353	261,607
TOTALI	92,529,737	63,946,706

13. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Kosto direkte	576,000	576,000
Kosto indirekte	2,297,097	1,739,383
TOTALI	2,873,097	2,315,383

Në zbatim të nenit 16, të Rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe Procedurat për Administrimin e tij” miratuar me VKM nr. 56 datë 03.10.2017, Fondi duhet t’i paguajë Agjencisë një pagesë vjetore për rimbursimin e kostove për administrimin e mjeteve financiare të Fondit.

Rimbursimi përfshin kosto direkte dhe kosto indirekte. Kostot direkte përbëhen nga shpenzime konsulence financiare në shumën 576,000 Lek (2021: 576,000 Lek), ndërsa kostot indirekte lidhen me koston e personelit të Agjencisë të përfshirë në procesin e administrimit të fondit në shumën 2,297,097 Lek (2021: 1,739,382 Lek). Për vitin 2022 Agjencia nuk paguan shpenzime mirëmbajtje të llogarisë së titujve AFISaR.

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME
Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

14. MARRËDHENIET DHE TRANSAKSIONET ME INSTITUCIONET, ORGANET DHE NDËRMARRJET SHTETËRORE

Agjencia konsideron transaksionet me palët e lidhura të Fondit, detajuar si më poshtë:

-Institucionet shtetërore me të cilat Fondi ka marrëdhënie në bazë të funksioneve të tij ligjore;

-Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, dhe drejtues të tjerë kryesorë të përcaktuar si persona që kanë autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë së Fondit, drejtpërdrejt ose terthorazi, duke përfshirë çdo drejtues (qoftë ekzekutiv ose ndryshe) të Agjencisë.

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave janë institucionet shtetërore, me të cilat Fondi ka ndërtuar marrëdhënie të rregullta në bazë të statusit dhe funksioneve të tij ligjore dhe në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse (shih dhe Shënimin 6).

Fondi drejtohet nga Këshilli Drejtues i Agjencisë, anëtarët e të cilit emërohen në përputhje me ligjin “Për sigurimin e depozitave nr.53/2014“, i ndryshuar. (Shënimi 2).

Aktivitetet financiare të Fondit janë investuar në instrumenta borxhi të emetuara nga Qeveria Shqiptare ose vendosur në depozita afatshkurtra apo llogari rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë (Shënimet 8 dhe 9). Investimet në letra me vlerë janë blerë vetëm në tregun primar përmes pjesëmarrjes në ankande.

Një përmbledhje e veprimeve me palët e lidhura është si në vijim:

Pasqyra e Pozicionit Financiar	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Llogaritë rrjedhëse në Bankën e Shqipërisë (shënimi 8)		
Depozitat afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (shënimi 8)	5,524,436	62,635,757
Investime në letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare (shënimi 9.1)	2,730,000	400,000
Detyrime ndaj Agjencisë (shënimi 10)	3,521,766,400	2,655,894,317
TOTALI	(2,873,097)	(2,315,381)
	3,527,147,740	2,716,614,693

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve	31 dhjetor 2022	31 dhjetor 2021
Të ardhura nga letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare (shënimi 12)	90,537,384	63,685,099
Të ardhura nga depozitat afatshkurtra në Bankën e Shqipërisë (shënimi 12)	1,992,354	261,607
Shpenzime për tarifën e administrimit (shënimi 15)	(2,297,098)	(1,739,383)
TOTALI	90,232,640	62,207,323

FONDI I NDËRHYRJES SË JASHTËZAKONSHME

Shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë në Lek, përveç se kur shprehet ndryshe)

15. ÇËSHTJE LIGJORE

Gjatë rrjedhës normale të aktivitetit për vitin 2022, Fondi nuk është përfshirë në veprime ligjore të cilat mund të kenë efekt mbi pozicionin financiar të Fondit, ose mund të sjellin ndryshime në aktive.

16. ANGAZHIME DHE GARANCI

Gjatë rrjedhës normale të aktivitetit, Fondi nuk ka angazhime apo garanci të marra apo të vendosura.

17. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje të ndodhura pas datës së raportimit financiar që mund të kërkojnë rregullim apo shpalosje të tjera kontabël në këto pasqyra financiare.